Shtypni TUNING MODE me përsëritje derisa "PRESET" të ndizet në panelin e ekranit. Pastaj, shtypni +/- me përsëritje.

Rregullim i zërit

Rregullim i zërit

Që të	Bëni këtë
Përforconi basin dhe të krijoni zë më të fuqishëm	Shtypni BASS BAZUCA.
Të zgjidhni efekt zëri të rregulluar prej më parë	Shtypni EQ me përsëritje. Që të anuloni efektin e zërit të rregulluar prej më parë, shtypni EQ me përsëritje që të zgjidhni "FLAT".

Krijim i një atmosfere zbavitjeje

(DJ EFFECT)

Përdorni butonat në njësi për të kryer këtë operacion.

1 Shtypni FLANGER, ISOLATOR, PHASER ose PAN.

Butoni i zgjedhur ndriçon dhe efekti është aktivizuar.

- FLANGER: Krijoni efekt të thellë flanaxhe që është e ngjashme me hungërimën e aeroplanit.
- ISOLATOR: Izoloni shtrirje të caktuar të frekuencës me rregullim të shtrirjeve tjera të frekuencave. Për shembull, kur doni të përqendrohemi tek vokalet.
- PHASER: Krijoni sërë kulmesh dhe kalimesh, si efekti fshirjeje.
- PAN: Krijoni ndjenjë që zëri lëviz rreth altoparlantëve mes kanalit majtas dhe djathtas.

2 Ktheni DJ CONTROL +/- që të rregulloni nivelin e efektit.

Për të shkyçur efektin

Shtypni butonin e efektit të zgjedhur përsëri.

Shënime

- DJ EFFECT-i shkyçet automatikisht kur shkyçni sistemin ose ndërroni funksionin ose shtrirjen e rregulluesit.
- Nuk mund të përdorni VOLUME/DJ CONTROL +/- që të rregulloni nivelin e zërit kur DJ EFFECT është aktivizuar. Shtypni VOLUME +/- në telekomandë të rregulloni nivelin e zërit.

Rregullim i efektit vertikal të zërit

Mund të rregulloni që efekti i zërit të ndërrohet automatikisht sipas stilit të instalimit të sistemit.

Kur instalohet horizontalisht, sistemi nxjerr stereo efekt zëri.

Kur instalohet vertikalisht, altoparlanti lart i rrit frekuencat me shtrirje të mesme, kurse altoparlanti poshtë i rrit frekuencat me shtrirje të ulët.

1 Shtypni OPTIONS.

2 Shtypni me përsëritje që të zgjidhni "VERTICAL SOUND", pastaj shtypni .

3 Shtypni me përsëritje që të zgjidhni "AUTO" or "OFF", pastaj shtypni .

Që të dilni nga menyja e opsioneve, shtypni OPTIONS.

Përdorimi i funksionit Party chain

Mund të lidhni më tepër audio sisteme në një zinxhir për të krijuar ambient më interesant zbvajtjeje dhe të krijoni dalje më të lart të zërit.

Aktivizoni një sistem në zinxhir të jetë “Nikoqir i Zbvajtjes” dhe të ndajë muzikën. Sistemet tjera do të jenë “Mysafir në Zbvajtje” dhe do të lëshojnë muzikë njëjtë si “Nikoqiri i Zbvajtjes”.


Rregullimi i Zinxhirit të Zbvajtjes

Mund të rregulloni një Zinxhir Zbvajtjeje duke i lidhur të gjitha sistemet me përdorim të audio kordonëve (nuk janë dhënë).


Para se të lidhni kordonët, sigurohuni që keni hequr kordonin elektrik.

A Nëse të gjithë sistemet kanë funksionin Zinxhir Zbvajtjeje

Sistemi i parë




Sistemi i dytë



Vazhdoni lidhjen deri në sistemin e fundit

Sistemi i fundit




Kur bëni lidhjen **A**


- Cilido sistem mund të jetë nikoqir në këtë lidhje.
- Mund të zgjidhni nikoqir të ri kur funksioni Zinxhir Zbvajtjeje aktivizohet. Për më tepër detaje, shihni “Zgjidhja e Nikoqirit të ri” (faqe 22).
- Në këtë lidhje, sistemi i fundit duhet të lidhet me sistemin e parë.

B Nëse njëri prej sistemeve nuk ka funksionin Zinxhir Zbvajtjeje

Sistemi i parë




Sistemi i dytë



Vazhdoni lidhjen deri në sistemin e fundit

Sistemi i fundit



Kur bëni lidhjen **B**

- Nuk mund të lidhni sistemin që nuk ka funksionin Zinxhir Zbvajtjeje në sistemin e fundit. Sigurohuni që keni zgjedhur funksionin që përshtatet me kyçësit “AUDIO IN” në sistemin e fundit.
- Duhet të zgjidhni sistemin e parë si nikoqir që të gjithë sistemet të lëshojnë muzikën e njëjtë kur të aktivizohet funksioni Zinxhir Zbvajtjeje.
- Në këtë lidhje, sistemi i fundit nuk lidhet me sistemin e parë.

Përdorim i Zinxhirit të Zbavitjes

Bëni procedurën në vijim që të aktivizoni funksionin Zinxhir Zbavitjeje.

- 1 Kyçni kordonin elektrik dhe kyçni të gjithë sistemet.**
- 2 Rregulloni nivelin e zërit në secilin sistem.**
- 3 Aktivizoni funksionin Zinxhir Zbavitjeje në sistemin që doni të jetë Nikoqiri i Zbavitjes.**

Shtypni FUNCTION +/- me përsëritje që të zgjidhni funksionin (përveç AUDIO IN) që doni, pastaj nisni riprodhimin.

Shtypni PARTY CHAIN në njësi. “PARTY” dhe “CHAIN” shfaqen në panelin e ekranit dy herë. Të gjithë sistemet lëshojnë muzikën e njëjtë si Nikoqiri i Zbavitjes.

Shënime

- Varësisht nga njësia e tërë e sistemeve që keni lidhur, Mysafir në Zbavitje mund të lëshojë muzikë me pak vonesë.
- Ndërrimi i nivelit dhe efektit të zërit në Mysafirin në zbavitje nuk do të ndikojë në daljen tek Nikoqiri i Zbavitjes.
- Mysafiri në Zbavitje vazhdon të lëshojë burimin e muzikës si Nikoqiri Zbavitjeje edhe kur të ndërroni funksionin në Mysafir Zbavitjeje.
- Sistemi që nuk është pajisur me funksionin Zinxhir Zbavitjeje nuk mund të bëhet Nikoqiri Zbavitjeje.
- Për më tepër detaje për operacionet e sistemeve tjera, shihni udhëzimet për përdorim të sistemit.

Për të zgjedhur Nikoqiri të Ri Zbavitjeje Kur bëni lidhjen **A**, mund të zgjidhni sistem tjetër si Nikoqiri të Ri Zbavitjeje. Përsëritni hapin 3 të “Përdorimi i Zinxhirit të Zbavitjes” në sistemin që doni të bëhet Nikoqiri i Ri Zbavitjeje. Nikoqiri aktual i Zbavitjes automatikisht do të bëhet Mysafir Zbavitjeje. Të gjithë sistemet lëshojnë muzikën e njëjtë si Nikoqiri i Ri i Zbavitjes.

Shënime

- Mund të zgjidhni vetëm edhe një sistem si Nikoqiri i Ri i Zbavitjes pasi të gjithë sistemet kanë mbaruar funksionin Zinxhir Zbavitjeje.
- Përsëritni hapin më lart nëse sistemi i zgjedhur nuk bëhet Nikoqiri i Ri Zbavitjeje pas disa sekondash.

Që të çaktivizoni Zinxhirin e Zbavitjes Shtypni PARTY CHAIN në njësinë e Nikoqirit të Zbavitjes.

Shënim

Përsëritni hapin më lart nëse sistemi nuk çaktivizon Zinxhirin e Zbavitjes pas disa sekondash.

Rregullimi i modit të zërit në Zinxhirin e Zbavitjes

Mund të rregulloni modin e zërit kur funksioni Zinxhir Zbavitjeje është aktivizuar.

Për efekt më të mirë të zërit në atmosferë zbavitjeje, rregulloni sistemet në anën e majtë të dhomës të nxjerrin zë vetëm në kanal in e majtë dhe sistemet në të djathtë, zë vetëm në kanal in e djathtë.

1 Shtypni OPTIONS.

2 Shtypni \uparrow/\downarrow me përsëritje që të zgjidhni “P.CHAIN MODE”, pastaj shtypni \oplus .

3 Shtypni \uparrow/\downarrow më përsëritje që të zgjidhni “STEREO”, “RIGHT CH” ose “LEFT CH”, pastaj shtypni \oplus .

- STEREO: Dalje e stereo zërit.
- RIGHT CH: Dalje e zërit monaural në kanal in e djathtë.
- LEFT CH: Dalje e zërit monaural në kanal in e majtë.

Për të dalë nga menya e opsioneve, shtypni OPTIONS.

Rregullim i ndriçimit të dritës

Mund të rregulloni ndriçimin e dritës nga një sërë motivesh të ndriçimit. Ndriçimi i dritës do të krijojë efekt ndriçimi bazuar në burimin e muzikës.

Shtypni LED SPEAKER me përsëritje.

Çdo herë që shtypni butonin, motivi ndërrohet.

Për të shkyçur ndriçimin e dritës

Shtypni LED SPEAKER me përsëritje që të zgjidhni "LED OFF".

Shënim

Nëse ndriçimi i dritës bën shumë shkëlqim, lëshoni dritat e dhomës ose shkyçni ndriçimin e dritës.

Përdorim i kohëmatësve

Sistemi ofron dy funksione të kohëmatësit. Nëse përdorni të dy kohëmatësit, Kohëmatësi i Gjumi ka përparësi.

Kohëmatësi i Gjumi

Mund t' ju zë gjumi derisa dëgjoni muzikë. Sistemi shkyçet pas kohës së dhënë prej më parë.

Shtypni SLEEP me përsëritje.

Për të anuluar Kohëmatësin, shtypni me përsëritje SLEEP që të zgjidhni "OFF".

Këshillë

Të shihni sa kohë ka mbetur para se të fiket sistemi, shtypni SLEEP.

Kohëmatës Riprodhimi

Mund të zgjoheni me rregulluesin ose pajisje USB në kohë të dhënë më parë. Sigurohuni që keni rregulluar orën.

- 1 Përgatitni burimin e zërit, pastaj shtypni VOLUME +/- për të rregulluar nivelin e zërit.
- 2 Shtypni TIMER MENU.
- 3 Shtypni \uparrow/\downarrow me përsëritje që të zgjidhni "PLAY SET", pastaj shtypni \oplus .
- 4 Vëni kohën kur të nisë riprodhimi. Shtypni \uparrow/\downarrow me përsëritje që të ndreqni orën/minutat, pastaj shtypni \oplus .
- 5 Përdorni procedurën e njëjtë si në hapin 4 për të dhënë kohën e mbarimit të riprodhimit.
- 6 Shtypni \uparrow/\downarrow me përsëritje që të zgjidhni burimin e zërit që doni, pastaj shtypni \oplus .
- 7 Shtypni të shkyçni sistemin.

Për të kontrolluar ndreqjen e orës ose për aktivizim të kohëmatësit përsëri

- 1 Shtypni TIMER MENU. "TIMERSEL" ndriçon në panelin e ekranit.
- 2 Shtypni \oplus .
- 3 Shtypni \uparrow/\downarrow me përsëritje për të zgjedhur "PLAY SEL", pastaj shtypni \oplus .

Për të anuluar kohëmatësin

Përsëritni procedurën e njëjtë si më lart dhe zgjidhni "OFF" në hapin 3, pastaj shtypni \oplus .

Shënime

- Sistemi kyçet para kohës së dhënë. Nëse sistemi është kyçur në kohën e dhënë ose nëse "STANDBY" ndriçon në panelin e ekranit, Kohëmatësi i Riprodhimit nuk do të riprodhojë.
- Mos e përdorni sistemin prej kohës kur ai kyçet derisa të nisë riprodhimi.

Përdorim i pajisjeve opsionale

- 1 Shtypni **VOLUME** – me përsëritje derisa “**VOL MIN**” të shfaqet në panelin e ekranit.
- 2 Lidhni pajisje opsionale (faqe 10).
- 3 Shtypni **FUNCTION +/-** me përsëritje që të zgjidhni funksionin **AUDIO IN**.
- 4 Lëshoni pajisjen e lidhur.
- 5 Shtypni **VOLUME +** me përsëritje që të rregulloni nivelin e zërit.

Shënim

Sistemi mund të hyjë në mod stendbaj automatikisht nëse niveli i zërit i pajisjes së lidhur është tepër i ulët. Rregulloni nivelin e zërit të pajisjes. Që të shkyçni funksionin e modit automatik stendbaj, shihni “Rregullim i funksionit automatik stendbaj” (faqe 24).

Çaktivizimi i butonave në njësi

(Child Lock)

Mund të çaktivizoni butonat në njësi (përveç) që të shmangni keqpërdorim, si dinakëri fëmijësh.

Mbani të shtypur **x** në njësi për mbi 5 sekonda.

“CHILD” dhe “LOCK ON” shfaqen në panelin e ekranit.

Mund të përdorni sistemin vetëm me përdorim të butonave në telekomandë. Për anulim, mbani të shtypur ■ në njësi për më se 5 sekonda derisa “CHILD” dhe “LOCK OFF” shfaqen në panelin e ekranit.

Shënim

Funksioni Child Lock do të anulohet kur të hiqni kordonin elektrik.

Rregullim i funksionit automatik stendbaj

Ky sistem është i pajisur me funksion automatik stendbaj. Me këtë funksion, sistemi automatikisht hyn në mod stendbaj kur për afro 15 minuta nuk ka përdorim ose dalje të audio sinjalit. Fillimisht, funksioni automatik stendbaj është i kycur.

1 Shtypni **OPTIONS**.

2 Shtypni **+/+** me përsëritje që të zgjidhni “**AutoSTBY**”, pastaj shtypni **+**.

3 Shtypni **↑ /+** me përsëritje që të zgjidhni to “**ON**” ose “**OFF**”.

Për të dalë nga menya e opsioneve, shtypni **OPTIONS**.

Shënime

- Mesazhi “AutoSTBY” ndriçon në ekran rreth 2 minuta para se të hyjë në modin stendbaj.
- Funksioni automatik stendbaj nuk funksionon gjatë funksionimit të rregulluesit.
- Sistemi mund mos të hyjë automatikisht në modin stendbaj në rastet në vijim:
 - kur zbulohet audio sinjal.
 - gjatë riprodhimit të audio skedarëve.
 - kur është në proces Kohëmatësi i Riprodhimit ose Kohëmatësi i Gjunit.

Ueb faqe për pajisje të përshtatshme

Kontrolloni ueb faqet më poshtë për informacionet më të fundit për pajisjet USB të përshtatshme dhe pajisjet *Bluetooth* të përshtatshme.

Për blerës në Amerikën Latine:

<<http://esupport.sony.com/LA>>

Për blerës në Shtetet e Bashkuara:

<<http://esupport.sony.com/>>

Për blerës në Evropë dhe Rusi:

<<http://support.sony-europe.com/>>

Për blerës në shtete/rajone tjera:

<<http://www.sony-asia.com/support>>

Mënjanim i problemeve

Nëse hasni në problem me sistemin tuaj, gjejeni në listën për mënjanim të problemeve më poshtë dhe merrni aksionin përmirësues.

Nëse problemi vazhdon, konsultohuni me shpërndarësin më të afërt të Sony-it.

Mbani mend që nëse personeli shërbyes ndërron ndonjë pjesë gjatë riparimit, këto pjesë mund të mbahen.

Nëse "PROTECT" dhe "EXX" (X është numër) shfaqen në panelin e ekranit

Menjëherë shkyçeni kordonin elektrik.

- Kontrolloni nëse diçka i bllokoi vrimat e ventilimit të njësisë.
- Hiqni pajisjen e lidhur USB. Sigurohuni që nuk ka problem me pajisjen USB.

Pasi të kontrolloni këto më lart dhe ndreqjes së problemeve, kyçni kordonin elektrik dhe kyçni sistemin. Nëse problemi vazhdon, konsultohuni me shpërndarësin më të afërt të Sony-it.

Përgjithshëm

Sistemi ka hyrë në mod stendbaj.

- Kjo nuk është gabim. Sistemi automatikisht hyn në mod stendbaj pas rreth 15 minuta pa përdorim ose dalje audio sinjali. (faqe 24).

Rregullimi i orës ose kohëmatësit është anuluar.

- Kordoni elektrik është shkyçur ose ka pasur ndalim rryme. Rregulloni përsëri orën (faqe 11) dhe kohëmatësin (faqe 23).

Nuk ka zë.

- Rregulloni nivelin e zërit.
- Kontrolloni lidhjen e pajisjes opsionale, nëse keni (faqe 10).
- Kyçni pajisjen e lidhur.

Ka zë ose zhurmë të lartë.

- Lëvizni sistemin larg burimeve të zhurmës.
- Lidhni sistemin në prizë tjetër muri.
- Instaloni filtër zhurme (bluhet në shitore) tek kordoni elektrik
- Shkyçni pajisjet elektrike përreth.

Kohëmatësi nuk funksionon.

- Kontrolloni rregullimet e kohëmatësit dhe rregulloni kohën saktësisht (faqe 23).
- Anuloni funksionin Kohëmatës Gjumi (faqe 23).

Telekomanda nuk funksionon.

- Hiqni pengesat mes telekomandës dhe njësisë.
- Lëvizni telekomandën më afër njësisë.
- Drejtoni telekomandën kah senzori i njësisë.
- Zëvendësoni bateritë (R6/madhësi AA).
- Lëvizni njësinë më larg dritës fluoreshente.

“CHILD” dhe “LOCK” shfaqen kur të shtypni cilëndo buton në njësi.

- Shkyçni funksionin Child Lock (faqe 24).

USB pajisje

Nuk ka zë.

- Pajisja USB nuk është lidhur siç duhet, Shkyçni sistemin dhe lidhni prej fillimi pajisjen USB, pastaj kyçni sistemin.


Ka zhurmë, kërcim ose zë i penguar.

- Përdorni pajisje USB që nuk ka mbështetje. Kontrolloni informatat në ueb faqe për pajisje USB të përshtatshme (faqe 25).
- Shkyçni sistemin dhe lidhni prej fillimi pajisjen USB, pastaj kyçni sistemin.
- Vetë skedari i muzikës përmban zhurmë ose zëri është i penguar. Mund të ketë hyrë zhurmë gjatë krijimit të skedarëve të muzikës për shkak të kushteve të kompjuterit. Përsëri krijoni skedarin e muzikës.
- Bitrejt i përdorur kur është koduar është i ulët. Dërgoni audio skedarë me bitrejt më të lartë në pajisjen USB.

“READING” shfaqet për kohë më të gjatë ose kalon shumë kohë derisa të nisë riprodhimi.

- Procesi i leximit mund të zgjat shumë në rastet në vijim:
 - Ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB.
 - Struktura e skedarit është shumë e ndërlikuar.
 - Kapaciteti i memories është i tepërt.
 - Memoria e brendshme është e fragmentuar.

Shfaqet “OVER CURRENT”.

- Është konstatuar problem me nivelin e rrymës elektrike nga  porti. Shkyçni sistemin dhe hiqni pajisjen USB nga porti. Sigurohuni që nuk ka problem me pajisjen USB. Nëse kjo vazhdon, kontaktimi me shpërndarësin më të afërt të Sony-it.

Ekran i pasaktë.

- Të dhënat e vëna në pajisjen USB mund të jenë dëmtuar, dërgoni përsëri të dhënat në pajisjen USB.
- Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky sistem janë vetëm numra dhe alfabet. Karakteret që nuk mund të shfaqen duken si “_”.

Pajisja USB nuk njihet.

- Shkyçni sistemin dhe lidhni prej fillimi pajisjen USB, pastaj kyçni sistemin.
- Kontrolloni informatat në ueb faqe për pajisje të përshtatshme USB (faqe 25).
- Pajisja USB nuk punon si duhet. Shihni udhëzimet për përdorim të pajisjes tuaj USB për atë se si të merreni me këtë problem.

Riprodhimi nuk nis.

- Shkyçni sistemin dhe lidhni prej fillimi pajisjen USB, pastaj kyçni sistemin.
- Kontrolloni informatat në ueb faqe për pajisje USB të përshtatshme (faqe 25).

Riprodhimi nuk nis nga skedari i parë.

- Vëni modin e riprodhimit në Mos Normal (faqe 12).

Audio skedar nuk mund të riprodhohet.

- MP3 skedarë në MP3 PRO format nuk mund të riprodhohen.
- Disa AAC skedarë mund të mos riprodhohen si duhet.
- Një AAC skedar që ka video nuk mund të riprodhohet.
- WMA skedarë në Windows Media Audio Lossless dhe Professional format nuk mund të riprodhohen.
- Pajisje USB të formatuara me sistemi dosjesh ndryshe nga FAT16 ose FAT32 nuk mbështeten.*
- Nëse përdorni pajisje USB të particionuar, vetëm skedarë në particionin e parë mund të riprodhohen.
- Sistemi mund të riprodhojë vetëm deri në thellësi prej 8 dosjesh.
- Skedarë që janë të koduara ose mbrojtura me fjalëkalim nuk mund të riprodhohen.

- Skedarë me DRM (Menaxhim Digjital i të Drejtave) mbrojtje të autorit nuk mund të riprodhohen nga ky sistem.

* Ky sistem mbështet FAT16 dhe FAT32, por disa pajisje USB mund të mos mbështetin këtë FAT. Për më tepër detaje, shihni udhëzimet për përdorim të çdo pajisjeje USB ose kontaktoni me prodhuesin.

Pajisje *Bluetooth*

Nuk mund të kryhet çiftim.

- Lëvizni pajisjen *Bluetooth* më afër sistemit.
- Çiftimi mund të mos jetë në disponim nëse ka pajisje tjera *Bluetooth* rreth sistemit. Në këtë rast, shkyçni pajisjet tjera *Bluetooth*.
- Sigurohuni që keni fjalëkalimin e saktë në pajisjen *Bluetooth*.

Pajisja *Bluetooth* nuk mund të gjejë njësinë ose “BT OFF” shfaqet në ekran.

- Vëni sinjalin *Bluetooth* në “BT ON” (faqe 18).

Lidhja nuk është e mundshme.

- Pajisja *Bluetooth* me të cilën doni të lidheni nuk mbështet profilin A2DP dhe nuk mund të lidhet me sistemin.
- Mundësoni funksionin *Bluetooth* të pajisjes *Bluetooth*.
- Krijoni lidhje nga pajisja *Bluetooth*.
- Informatat për regjistrim të çiftimi janë fshirë. Kryeni përsëri çiftimin.
- Fshini informatat e regjistrimit të çiftimit në pajisje *Bluetooth* dhe kryeni çiftimin përsëri.

Zëri kërcen ose ndryshon ose lidhja humbet.

- Sistemi dhe pajisja *Bluetooth* janë larg njëra tjetrës.
- Nëse ka pengesa mes sistemit dhe pajisjes tuaj *Bluetooth*, hiqni ose ikni pengesave.

- Nëse ka pajisje që prodhon rrezatim elektro-magnetik, si LAN pa tel, pajisje tjetër *Bluetooth* ose mikrovalë në afërsi, hiqni anësh.

Zëri i pajisjes tuaj *Bluetooth* nuk mund të dëgjohej në këtë sistem.

- Së pari rritni nivelin e zërit në pajisjen tuaj *Bluetooth*, pastaj rregulloni nivelin e zërit me VOLUME +/-.

Ka zë, zhurmë ose zë të penguar të lart.

- Nëse ka pengesa mes sistemit dhe pajisjes tuaj *Bluetooth*, hiqni ose ikni pengesave.
- Nëse ka pajisje që prodhon rrezatim elektro-magnetik, si LAN pa tel, pajisje tjetër *Bluetooth* ose mikrovalë në afërsi, hiqni anësh.
- Ulni nivelin e zërit të pajisjes së lidhur *Bluetooth*.

Rregullues

Ka zë ose zhurmë shumë të lartë ose stacionet nuk mund të pranohen. (“TUNED” ose “ST” ndriçon në panelin e ekranit.)

- Lidhni antenën si duhet.
- Ndërroni vendin e antenës dhe orientimin e saj për pranim të mirë.
- Lidhni antenë të jashtme që blihet në shitore.
- Shkyçni pajisjet elektrike përreth.

Zinxhir i Zbavitjes

Funksioni Party Chain nuk mund të aktivizohet.

- Kontrolloni lidhjen (faqe 21).
- Sigurohuni që audio kordonët janë lidhur si duhet.

“PARTY” dhe “CHAIN” ndriçojnë në panelin e ekranit.

- AUDIO IN funksioni zgjidhet gjatë funksionit Party Chain. Shtypni FUNCTION +/- me përsëritje që të zgjidhni funksionin tjetër.
- Ri-filloni sistemin.

Funksioni Party Chain nuk punon si duhet.


- Shkyçeni sistemin. Pastaj, kyçeni sistemin dhe aktivizoni funksionin Party Chain.

Për ri-rregullim të sistemit

Nëse sistemi akoma nuk funksionon si duhet, ri-rregulloni sistemin në rregullimet fillestare të fabrikës. Përdorni butonat në njësi për këtë.

1 Shkyçni dhe kyçni kordonin elektrik.

2 Shtypni kyçe të sistemit.

3 Derisa mbani të shtypur , shtypni FUNCTION për afro 3 sekonda. “RESET” shfaqet në panelin e ekranit. Të gjitha rregullimet e vëna nga përdoruesi, si radio stacionet, kohëmatësit dhe ora kthehen në rregullimet fillestare të fabrikës.

Mesazhe

Një nga këto mesazhe mund të shfaqet në panelin e ekranit gjatë përdorimit.

CHILD LOCK

Funksioni Mbyllje për Fëmijë është mundësuar.

CONNECT

Sistemi lidhet me pajisjen e lidhur të fundit gjatë funksionit *Bluetooth*.

ERROR

Pajisja USB nuk është njohur ose është lidhur pajisje e panjohur.

GUEST

Sistemi bëhet Mysafir Zbavitjeje kur aktivizohet funksioni Party Chain.

HOST

Sistemi bëhet Nikoqir Zbavitjeje kur aktivizohet funksioni Party Chain.

NoDEVICE

Nuk është lidhur asnjë pajisje USB.

NO TRACK

Nuk është vënë skedar që mund të riprodhohet në sistem.

NOT SUPPORT

Është lidhur pajisje USB që nuk mbështetet ose pajisja USB është lidhur nëpërmjet USB nyjës.

PAIRING

Sistemi është në mod çiftimi.

READING

Sistemi lexon informatat nga pajisja USB. Disa funksione nuk janë në disponim.

TIME NG

Koha e kyçjes dhe shkyçjes e Kohëmatësit të Riprodhimit janë njësoj.

Përkujdesje

Për siguri

- Krejtësisht çlidhni kordonin elektrik (kryesorin) nga priza e murit (kryesorin) nëse nuk do të përdoret për kohë të gjatë. Kur shkyçni pajisjen, çdoherë kapni kyçësen. Asnjëherë mos e tërhiqni kordonin.
- Nëse hyn ndonjë objekt i fortë ose i lëngshëm në sistem, shkyçni sistemin nga priza dhe le ta kontrollojë personel i kualifikuar para se ta përdorni përsëri.
- (Për blerësit në SHBA)
Njëri teh i prizës është më e gjerë se tjetri për shkaqe sigurie dhe do të hyjë në prizën e murit vetëm në një anë. Nëse nuk mund të vëni prizën krejtësisht në prizën e murit, kontaktoni shpërndarësin tuaj.
- Kordoni me rrymë elektrike duhet të ndërrohet vetëm në shitore me shërbime të kualifikuara.

Për vendosje

- Mos e vëni sistemin në pozitë tatëpjetë ose në vende ku është shumë nxehtë, ftohtë, me pluhur, papastër ose me lagështi ose ku nuk ka ventilim të përshtatshëm ose nënstruar dridhjeve, dritës direkt të diellit ose dritës së fortë.
- Kini kujdes kur vëni sistemin në sipërfaqe që kanë pasur trajtim të veçantë (për shembull, dyllë, vaj, luster) pasi që mund të ketë njolla ose ndryshim në ngjyrë.
- Nëse sistemin keni sjellë nga një vend shumë i ftohtë direkt në një vend shumë të nxehtë ose nëse vendohet në dhomë me shumë lagështi, lagështia mund të kondensojë në lentën brenda njësisë dhe të shkaktojë funksionim të gabuar të sistemit. Në këtë situatë, shkyçeni sistemin dhe lëni ashtu derisa lagështia të avullohet.

Për ngrohje të tepërt

- Ndrohja e tepërt e njësisë gjatë funksionimit është normale dhe nuk është shkak për brengosje.
- Mos prekni dollapin nëse është përdorë pa ndërprerë në nivel të lart të zërit pasi që dollapi mund të është nxehtë shumë.
- Mos i pengoni vrimat e ventilimit.

Për sistemin e altoparantëve

Sistemi i brendshëm i altoparantëve nuk është magnetikisht i mbrojtur dhe fotografia në TV-të në afërsi mund të pengohen magnetikisht. Në këtë situatë, shkyçni TV-në, pritni 15-30 minuta dhe pastaj kyçeni përsëri. Nëse nuk ka përmirësim, lëvizni sistemin sa më larg TV-së.

Pastrim i dollapit

Pastroni këtë sistem me leckë të butë pak të lagur me detergjent të butë. Mos përdorni prodhime abrazive, pudër fërkimi ose tretës si hollues, benzinë ose alkoool.

Për komunikimin Bluetooth

- Pajisjet *Bluetooth* duhet të përdoren brenda përafërsisht 10 metrash (33 feet) (largësi e papenguare) nga njëra tjetra. Shtrirja e komunikimit efektiv mund të shkurtohet në kushtet në vijim:
 - Kur një person, objekt metalik, mur ose pengesë tjetër ndodhet mes pajisjeve me lidhje *Bluetooth*
 - Vende ku është instaluar LAN pa tel
 - Rreth furrave mikrovale që përdoren
 - Vende ku ka valë tjera elektro-magnetike

- Pajisje *Bluetooth* dhe LAN pa tel LAN (IEEE 802.11b/g) përdorin shtrirjen e njëjtë të frekuencës (2.4 GHz). Kur përdorni pajisjen tuaj *Bluetooth* afër një pajisjeje me mundësi LAN, mund të ketë pengesë elektro-magnetike. Kjo mund të shkaktojë transfer më të ngadalshëm të të dhënave, zhurmë ose pamundësi për lidhje. Nëse ndodh kjo, provoni njërën prej këtyre ndreqjeve:
 - Mundohuni të lidhni këtë sistem dhe pajisjen *Bluetooth* kur të jeni së paku 10 metra (33 feet) larg pajisjes për LAN pa tel.
 - Shkyçni pajisjen për LAN pa tel nga rryma kur e përdorni pajisjen tuaj *Bluetooth* brenda 10 metrave (33 feet).
- Radio valët të transmetuara nga kjo pajisje mund të pengojnë funksionimin e disa pajisjeve shëndetësore. Pasi që ky pengim mund të shkaktojë funksionim të keq, gjithmonë shkyçni këtë sistem dhe pajisjen *Bluetooth* në vendet e ardhshme:
 - Në spitale, trena, aeroplanë, stacione, në pompa benzine dhe çfarëdo vendi ku mund të ketë gazra djegës.
 - Afër deryve automatike ose alarm zjarri.
- Ky sistem mbështet funksione sigurie që janë në përputhje me specifikimet e *Bluetooth*-it si mundësi për të siguruar sigurinë gjatë komunikimit me teknologjinë *Bluetooth*. Sidoqoftë, kjo siguri mund të mos mjaftojë varësisht nga përmbajtja e rregullimeve dhe faktorë tjerë, ashtu që gjithmonë keni kujdes kur përdorni teknologjinë *Bluetooth*.
- Sony nuk të jetë përgjegjës në çfarëdo mënyrë për dëme ose humbje tjera që janë rezultat i informatave të marra gjatë komunikimit me *Bluetooth* teknologjinë.
- Komunikimi *Bluetooth* nuk është doemos i garantuar me të gjitha pajisjet *Bluetooth* që kanë profilin e njëjtë me këtë sistem.
- Pajisjet *Bluetooth* të lidhura me këtë sistem duhet të jenë në pajtim me specifikimet e *Bluetooth*-it të dhëna nga Bluetooth SIG, Inc. dhe duhet të jenë të certifikuar që janë në pajtim. Sidoqoftë, edhe kur pajisja është në pajtim me specifikimet e *Bluetooth*-it, mund të ketë raste ku karakteristikat apo specifikimet e pajisjes *Bluetooth* e bëjnë të pamundshme lidhjen ose mund të rezultojë në metoda të ndryshme të kontrollit, ekranit ose përdorimit.
- Zhurmë mund të ndodhë ose zëri mund të ndalet varësisht nga pajisja *Bluetooth* e lidhur me këtë sistem, ambientin e komunikimeve ose kushtet rrethuese.

Specifikime

SPECIFIKIME TË AUDIO FUQISË

DALJA E FUQISË ELEKTRIKE DHE PENGESA HARMONIKE TOTALE: (vetëm për modelet ne ShBA)

Me ngarkesa 6 om, ta dy kanalet në përdorim, nga 120 – 10,000 Hz; vlerësuar 75 vatë për kanal minimum RMS fuqi, me jo më tepër se 0.7% pengesë harmonike totale nga 250 milivatë për dalje të vlerësuar.

Pjesa e përforcuesit

Janë matur vlerat në vijim

Modeli në ShBA:

AC 120 V, 60 Hz

Modeli në Meksikë:

AC 127 V, 60 Hz

Modelet evropiane dhe ruse:

AC 220 V – 240 V, 50/60 Hz

Modelet çileane dhe boliviane:

AC 220 V – 240 V, 50 Hz

Modele tjera:

AC 120 V – 240 V. 50/60 Hz

Dalje e rrymës (vlerësuar)

150 W + 150 W (at 6 om, 1 kHz,

1% THD)

RMS rrymë dalje (referencë)

250 W + 250 W (për kanal më

6 om, 1 kHz)

Hyrje

AUDIO IN/PARTY CHAIN IN L/R

Voltazh 2 V, rezistencë 47 kilom

Dalje

AUDIO OUT/PARTY CHAIN OUT L/R

Voltazh 2 V, rezistencë 1 kilom

Pjesa e USB-së

Formate të mbështetura

MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3):

32 kbps – 320 kbps, VBR

WMA: 48 kbps – 192 kbps

AAC: 48 kbps – 320 kbps

WAV: 16 bit PCM

Frekuenca krahasimi

MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3):

32 kHz/44.1 kHz/48 kHz

WMA: 32 kHz/44.1 kHz/48 kHz

AAC: 32 kHz/44.1 kHz/48 kHz

WAV: 8 kHz – 48 kHz

Pajisje e mbështetur USB

Mass Storage Class

Maksimum momental

1 A

⚡ (USB) port

Tip A

Pjesa Bluetooth

Sistem komunikimi

Bluetooth Standard version 3.0

Dalje

Bluetooth Standard Power Class 2

Shtirrije maksimale e komunikimit

Vijë pamjeje për af. 10 m¹)

Shtirrije e frekuencës

2.4 GHz band (2.4000 GHz –
2.4835 GHz)

Metodë modulimi

FHSS (Freq Hopping Spread
Spectrum)

Profile të përshatshme Bluetooth²)

A2DP (Advanced Audio Distribution
Profile)

AVRCP 1.3 (Audio Video Remote
Control Profile)

Kodekse të mbështetura

SBC (Sub Band Codec)

AAC (Advanced Audio Coding)

aptX (aptX Codec)

1) Shtrirja e vërtetë mund të ndryshojë varësisht nga faktorë si pengesa mes pajisjeve, fusha magnetike rreth furrës mikrovalë, elektricitet statik, prekshmëri pranimit, performanca e antenës, sistemi operativ, aplikacioni i softuerit, etj.

2) Profilet standarde të *Bluetooth*-it tregojnë qëllimin e *Bluetooth* komunikimit mes pajisjeve.

Pjesa e FM rregulluesit

FM stereo, FM superheterodyne tuner

Antena

FM antenë teli

Shtrirje rregullimi

Modeli në ShBA:

87.5 MHz – 108.0 MHz (hap 100 kHz)

Modele tjera:

87.5 MHz – 108.0 MHz (hap 50 kHz)

Pjesa e altoparlantit

Sistemi i altoparlantit

2-anë, Bass refleks

Njësia e altoparlantit

Vufer: 200 mm (7 7/8 in), tip koni

Tviter: 66 mm (2 5/8 in), tip koni

Rezistencë e vlerësuar

6 om

Përgjithësisht

Kërkesa për rrymës

Modeli në ShBA:

AC 120 V, 60 Hz Modeli në

Meksikë: AC 127 V, 60 Hz

Modelet evropiane dhe ruse:

AC 220 V – 240 V, 50/60 Hz

Modelet çileane dhe

boliviane: AC 220 V – 240 V,

50 Hz Modelet tjera:

AC 120 V – 240 V, 50/60 Hz

Përdorim i rrymës

110 W

Përdorim i rrymës (në mod Kursimi të Energjisë)

Modelet evropiane dhe ruse:

0.5 W (Kur “BT STBY” është në “OFF”)

6 W (Kur “BT STBY” është në “ON”)

Dimensione (gj/l/th) (Përafër.)

757 mm × 303 mm × 363 mm

(29 7/8 in × 12 in × 14 3/8 in)

Masa (Përafër.)

13.8 kg (30 lb 7 oz)

Shtojca të dhëna

Telekomanda (1)

Bateri R6 (Madhësi AA) (2)

FM antenë teli (1)

Dizajni dhe specifikimet mund të ndërrohen pa paralajmërim.

<http://www.sony.net/>



©2014 Sony Corporation

* 4 4 8 5 7 9 0 1 3 * (2)